



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË

Nr. _____ prot.

Datë _____ / _____ / 2020

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: **ALKO IMPEX GENERAL CONSTRUCTION shpk**

Adresa: Tiranë Rruga Reshit Petrela, Kompleksi Usluga, kati i 8, prane stacionit te trenit

Procedura e prokurimit: E HAPUR MBI KUFIRIN E LARTË MONETAR

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-52946-03-04-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës:

1. Fondi limit: **255,581,960** (dyqind e pesëdhjetë e pesë milion e pesëqind e tetëdhjetë e një mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) **lekë pa tvsh.**
2. Burimi i Financimit: **TË ARDHURAT E BASHKISË KAVAJË**
3. Objekti i kontratës: **SHËRBIMI I PASTRIMIT TË NJËSISË ADMINISTRATIVE GOLEM.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët** ●, oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Korsel shpk, Nipt-i J64104124G vlera **215,679,760** (dyqind e pesëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa tvsh
2. Alko Impex General Construction shpk, Nipt-i K91326028I, vlera **254,527,782** (dyqind e pesëdhjetë e katër milion e pesëqind e njëzet e shtatë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e dy) lekë pa tvsh
3. Rej shpk, Nipt-i J93711608Q vlera **0** (zero) lekë pa tvsh

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Korsel shpk
2. Rej shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori ekonomik **Korsel shpk** u skualifikua duke qenë se nuk plotëson këto kriteret:

- Nuk plotëson kriterin lidhur me certifikatat ISO të kërkuara në pikën 2.3.3 ku është parashikuar "Operatorët ekonomikë, për të vërtetuar se punët, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Si rrjedhojë OE KORSEL shpk nuk plotëson këtë kriter pasi certifikatat ISO janë të lëshuara nga organe të cilat nuk janë të akredituara nga Drejtoria e

Përgjithshme e Akreditimit.

- Nuk plotëson kriterin 2.3.2. pika 2 në të cilin është parashikuar “Për të përmbushur këtë kapacitet operatorët ekonomikë duhet të paraqesin gjithashtu kontratë pune të vlefshme dhe dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi nga një organizëm akredituar/licencuar/certifikuar shqiptar ose i huaj për 1(një) inxhinier i specializuar për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 date 18.02.2010 “Per sigurine dhe shendetin ne pune” dhe V.K.M. nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, i cili duhet te jetë i listuar në Listëpagesat e operatorit ekonomik gjatë periudhës Janar 2019 – Shkurt 2020. Certifikata e paraqitur e drejtuesit teknik nuk rezulton të jetë i akredituar/licencuar/certifikuar nga një organ në përputhje me kërkesat e ligjit 10237 datë 18.02.2010 dhe VKM nr. 312 datë 05.05.2010.
- Nuk plotëson kriterin 2.3.6. pika 3 ku është kërkuar “Makine teknologjike transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, jo më pak se 1 (një) cope”. Referuar lejes së qarkullimit rezulton se mjeti I paraqitur si mjet teknologjik transportues është kamioncinë e thjesht pra kategoria ATP kurse mjeti i duhur i kërkuar nga AK kërkohet mjet teknologjik I cili duhet jetë APV referuar lejes përkatëse respektive.
- Nuk plotëson kriterin e kërkuar 2.3.6 të ndryshuar ku AK ka kërkuar: “Për mjetet në pronësi/qera, Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku Autoriteti Kontraktor brenda 5 (pesë) ditëve nga mbyllja e dorëzimit të ofertave rezervon të drejtën e verifikimit të tyre. Në këtë deklaratë do të jepen të dhëna të sakta të kontaktit të operatorit ekonomik si: Numër cel, adresë e-mail, adresa e selisë së shoqërisë. Nga ana e autoritetit kontraktor do të dërgohet një njoftim si në adresën elektronike në SPE edhe në të dhënat e kontaktit të OE ku do të përcaktohet data dhe ora e paraqitjes së mjeteve pranë ambienteve të Bashkisë Kavaje. Në rast se Operatori ekonomik nuk i paraqet apo disponon të gjitha mjetet e deklaruara në tender, do të përbëj shkak për skualifikim. Gjithashtu ndryshimet që mund të përkojnë me të dhënat e mjetit të deklaruar dhe atyre që të rezultojnë nga verifikimi fizik i tyre do të përbëjë shkak për skualifikim dhe nisjen e procedurave administrative parashikuar nga neni 13 i ligjit 9643 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur rezulton se OE Korsel shpk ka paraqitur një deklaratë ku i jep të drejtën autoritetit për verifikimin e mjeteve brenda 5 ditëve nga data e lidhjes së kontratës kur ndërkohë në DST, AK ka përcaktuar qartësisht se deklarata duhet të lëshohet për afatin 5 ditor nga dita e mbylljes së ofertave.
- Nuk plotëson kriterin 2.3.7. ku është kërkuar: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të kenë në dispozicion apo që mund t'i vihet në dispozicion për të përmbushur kontratën ambient me sipërfaqe jo më e vogël se 1000 m2 e cila do të shërbejë si pikë për parkim për mjetet dhe të tjera. Për të provuar këtë duhet të paraqitet dokument i vlefshëm që vërteton pronësinë. Në rastin kur ambjenti merret me qira duhet të paraqitet kontratë e vlefshme qiraje dhe dokument i vlefshëm që vërteton pronësinë e qiradhënësit. Në plotësim të kërrij kriteri është paraqitur një kontratë qiraje midis shoqërisë KORSEL shpk dhe qiradhënësit Z. Altin Dupi dhe Znj. Irena Dupi, me objekt dhënie me qera të sipërfaqes në pronësi të tyre për llogari të shoqërisë KORSEL shpk. Nga verifikimi pranë ASHK Kavajë i statusit ligjor të pasurisë me nr 18/290 zk 8552 Kavajë rezulton se në seksionin D të kartelën me datë 17.01.2019 është bërë shënimi “Kontratë qeraje me nr 162/88 datë 17.01.2019 ndërmjet pronarit dhe Shoqërisë Dupi-Frut shpk me afat 15 vjet”. Kontrata e paraqitur nuk është e vlefshme dhe nuk plotëson kriterin e mësipërm pasi në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate pasuria nuk ka qënë e lirë dhe nuk ka qënë në posedim të pronarit.

- Nga verifikimi i kryer nga Autoriteti Kontraktor pranë FSHU (OSHEE GROUP) rezulton se OE Korsel shpk nuk permbush detyrimet përsa i përket shlyerjes së detyrimeve që rrjedhin nga përdorimi energjisë elektrike në kundërshtim me VKM nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, pasi rezulton se për kontratën me numër TR1FC020004008686 tarifohet si subjekt familjar e jo si privat, kriteri bazë që duhet të plotësohet për pajisjen me Vërtetim Debie është deklarimi vullnetar i të gjithë kontratave të furnizimit me energji elektrike për të gjithë objektet e ushtrimit të aktivitetit të subjektit sipas ekstraktit të QKR-së, detyrim i cili nuk është zbatuar nga ana e shoqërisë “Korsel” sh.p.k e cila ka sjellë si pasojë mospagimin e diferencës së detyrimit të lindur midis tarifimit si biznes dhe atij familjar. Pra operatori ekonomik “KORSEL” sh.p.k., me dokumentacionin e dorëzuar prej tij nuk e plotëson kriterin e lartpërmendur të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi ka paraqitur një dokument për kontratat e furnizimit me energji elektrike të klientëve familjarë, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për kontratën e furnizimit me energji elektrike të operatorëve ekonomikë, të cilët i nënshtrohen tarifave më të larta të pagimit të energjisë elektrike.

K.V.O. e cilëson ofertën e këtij operatori të **refuzuar**.

2. Operatori ekonomik **Rej shpk** u skualifikua duke qenë se nuk plotëson këto kritere:

- Me shkresën nr.1662 Prot. datë 20.05.2020 operatori ekonomik Rej shpk ka njoftuar tërheqjen nga procedura.

K.V.O. e cilëson ofertën e këtij operatori të **refuzuar**.

* * * * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Alko Impex General Construction shpk** se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej 254,527,782 (dyqind e pesëdhjetë e katër milion e pesëqind e njëzet e shtatë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e dy) lekë pa tvsh është identifikuar si ofertë e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Kavajë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të zbatohen dispozitat që parashikohen në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 09.06.2020

Ankesa : Nuk ka patur

Kryetari
Redjan KRALI